

VENDIM
Nr. 9, datë 23.1.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K”
SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “f”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/2 prot., datë 18.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 67 prot., datë 10.1.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.4, gjerat “a”, “b” dhe “d”. Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- *germa “b”*: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

- *germa “c”*: shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin strukturën organizative të saj dhe gjithashtu të depozitojë në ERE informacion mbi stafin teknik të kësaj strukture që do të angazhohet me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- *germa “b”*: shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat e saktësuara të vitit 2020 dhe të përcjellë në format origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin pasqyrat financiare për vitin 2021. Gjithashtu, shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE kontratën e huas/kontratën e kredisë, sikurse parashikuar në planin e biznesit, për të mbuluar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën një muaj.

Pika 2.4 Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike;

- *germa "t"*: shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal ose fotokopje e njësuar me origjinalin kontratën e qirasë për disponimin e ambientit për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike. Po ashtu, duke qenë se afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do të saktësohet me shoqërinë, nëse ky do të jetë dokument i përkohshëm që shërben vetëm për momentin e aplikimit deri në përfundim të afatit të kontratës apo do të sjellë një kontratë qiraje që do të mbulojë të gjithë periudhën 5-vjeçare të licencimit.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "G.S.K" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti